

# Një Vlerësim i Vendimit të Kosovës për të refuzuar Projektin e Gazësjellësit: Humbjet gjeostrategjike dhe implikimet

Prill 2022



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

---

[legalpoliticalstudies.org](http://legalpoliticalstudies.org)

## NJË VLERËSIM I VENDIMIT TË KOSOVËS PËR REFUZIMIN E PROJEKTIT TË GAZËSJELLËSIT: HUMBJET GJEOSTRATEGJIKE DHE IMPLIKIMET

Autore: Barbara Matias\*

Prill 2022

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, prill 2022.

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve ose Bordit(eve). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose në çfarëdo mënyre pa leje. Për kërkesa të tilla kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

“Rexhep Luci” str. 16/1

Prishtina 10 000, Kosovo

Website: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)

E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)

Tel/fax.: +381 38 234 456

\*Bashkëpunëtore e jashtme

# NJË VLERËSIM I VENDIMIT TË KOSOVËS PËR REFUZIMIN E PORJEKTIT TË GAZËSJELLËSIT: HUMBJET GJEOSTRATEGJIKE DHE IMPLIKIMET

## HYRJE

Qëndrueshmëria është rruga drejt së ardhmes. Në botën pas pandemisë, liderët botërorë konsiderojnë se investimet në tranzicionet dixhitale dhe ato të gjelbra janë mënyra më optimale për të nxitur rimëkëmbjen dhe zhvillimin ekonomik. Republika e Kosovës ende përballet me probleme serioze të ndotjes së mjedisit si dhe sigurinë energjetike, ndonëse kjo është temë diskutimi në Kuvend dhe me partnerët e saj.

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Kosova mbetet prapa sa i përket efikasitetit të energjisë dhe diversifikimit të furnizimit. Vendet si Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë blerë LNG-në amerikane, ndërsa Serbia përmes projekteve të reja energjetike ndërkufitare po e promovon veten si një rrugë tranziti e gazit, në anën tjetër Kosova ende varet nga termocentralet e paqëndrueshme dhe të stërvjetëruara të qymyrit.

Plani aktual i qeverisë është të përtrijë termocentralet e vjetruara dhe, në radhë të parë, të ecë përpara drejt një tranzicion të gjelbër për të krijuar një ekonomi ciklike dhe siguruar burime të ripërtrishme të energjisë. Për këtë arsye, qeveria e Albin Kurtit morri vendimin kontravers për refuzimin e investimit nga Shtetet e Bashkuara në vlerë prej 200 milionë dollarësh për ndërtimin e një gazsjellësi ndërkufitar të gazit natyror, që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut dhe më tej me Gazsjellësin Trans-Adriatik të Greqisë.

Kjo analizë politikash do t'a analizojë marrëveshjen dhe projektin e propozuar të gazsjellësit, të udhëhequr nga agjencia federale e Shteteve të Bashkuara, Korporata Millennium Challenge, si dhe projekte të ngjashme ndërkufitare të gazit natyror në të gjithë Evropën. Për më tepër, punimi thellohet në implikimet që ky vendim i qeverisë mund të ketë në marrëdhëniet dypalëshe SHBA-Kosovë, gjithashtu të ardhmen e planeve energjetike të Kosovës dhe sigurinë e përgjithshme energjetike.

## I. GAZËSJELLËSI: ÇFARË ËSHTË DHE CILI ËSHTË QËLLIMI I TIJ

Në kohën e globalizimit që po jetojmë tani, sistemet e transportit për lëvizjen e mallrave dhe materialeve në distanca të gjata janë një komoditet i çmuar. Tubacionet mundësojnë transportimin mallrave të ndryshme, nga ujërat e zeza në ujë dhe, më së shpeshti, mallra për qëllime energjetike. Kategoria e fundit përfshin naftën, biokarburantet, gazin e lëngshëm të naftës dhe gazin natyror. Rrjetet e mëdha të shpërndarjes janë esenciale për transportin e lëndëve djegëse dhe të energjisë në mbarë botën. Megjithatë, duke qenë se tubacionet janë ndërtuar nën tokë dhe për këtë arsye nuk shihen, qytetarët kryesisht nuk janë në dijeni të ekzistencës së rrjeteve dhe punës së transportit. Rasti që do të eksplorojë ky punim ka të bëjë me një tubacion gazi natyror që lidh disa vende të Ballkanit Perëndimor që mbështetet financiarisht nga qeveria e Shteteve të Bashkuara.

Midis shumëllojshmërisë së gjerë të tubacioneve të shpërndarjes, tubet e gazit natyror transportojnë gaz natyror nga puset e prodhimit të gazit (ose objektet e importit/eksportit) në mënyrë që ta shpërndajnë atë drejtpërdrejt në porte, qytete, shtëpi ose në objekte të tjera eksporti për të vazhduar më tej shpërndarjen. Linjat më të mëdha të tubacioneve të transmetimit transportojnë mallrat në qytete, ndërsa linjat më të vogla të shpërndarjes së shërbimit lidhin linjat kryesore me pikat përfundimtare lokale, si shtëpitë dhe bizneset.

Duke qenë se është një sistem i transportit të energjisë, është shumë e rëndësishme që mbikëqyrja rregullatore të bëhet saktësisht për të garantuar sigurinë e tij. Kjo përfshin masat e

sigurisë në nivelin e projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tubave për të parandaluar derdhjet e gazit të rrezikshëm.

## II. PROJEKTI I PROPOZUAR NGA SHBA PËR SHPËRNDARJE TË GAZIT NË KOSOVË

Shtetet e Bashkuara janë pale përfshirëse në rritjen e sektorit energjetik të Kosovës që shumë kohë. Nëpërmjet granteve dhe projekteve, objektivi kryesor është ulja e varfërisë nëpërmjet rritjes ekonomike, qoftë përmes investimeve në reformën energjetike për balancimin e sistemit energjetik, zhvillimin e sektorit të gazit apo shpërndarjen e energjisë elektrike. Duke e ngushtuar atë në projektin që eksploron ky dokument, granti dhe ekzekutimi trajtohen nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), një agjenci federale e SHBA-së që promovon rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë. Në vitin 2017, MCC dhe Qeveria e Kosovës kishin nënshkruar tashmë një program<sup>1</sup> fillestar prej 49 milionë dollarësh për të zbatuar politika dhe reforma institucionale, të cilat adresojnë mangësitë e furnizimit me energji elektrike dhe kostot e larta të ngrohjes, duke inkurajuar investime në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe duke promovuar burime më të pastra e më të lira të energjisë për ngrohje. Për më tepër, programi synon të optimizojë financimin e sektorit privat për t'u mundësuar prodhuesve të pavarur të energjisë që të sjellin furnizim shtesë me energji.

Përveç programit të paraqitur më lart, Bordi i Drejtorëve të MCC-së zgjodhi Kosovën për të zhvilluar një program kompakt<sup>2</sup> në shtator 2018 për zhvillimin e sektorit energjetik të vendit. Raporti Vjetor 2019 i MCC-së thekson se "Qeveria e Kosovës propozoi projekte për të adresuar sfidat ekonomike që lidhen me kërkesën e tepërt për energji elektrike dhe furnizimin e paparashikueshëm të energjisë. Me ndihmën e MCC-së, Qeveria planifikon të kryejë studime fizibiliteti për të vlerësuar qëndrueshmërinë e zhvillimit të sektorit të saj të gazit natyror, balancimin e sistemit energjetik me rezervat e energjisë, përmirësimin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe forcimin e institucioneve dhe politikave të sektorit të energjisë"<sup>3</sup>. Në këtë rrjedhë u zhvillua një studim fizibiliteti në vlerë prej 6.9 milionë dollarësh<sup>4</sup>, ku qeveria e Kosovës vendosi të avancojë me projektet për "zhvillimin e sektorit të gazit dhe krijimin e rezervave energjetike me qëllim të lehtësimit të integritet të burimeve të ripërtrishme, lehtësimit të varësisë së Kosovës nga qymyri dhe arritjes së qëllimeve të dekarbonizimit."<sup>5</sup>. Në vitin 2021, Kosovës iu dha një grant prej 200 milionë dollarësh për të ofruar "qasje të përditësuar dhe të riafirmuar në energji të qëndrueshme dhe të përbalueshme si pengesë për rritjen ekonomike të Kosovës"<sup>6</sup>. Kosova ishte i vetmi vend partner evropian i përzgjedhur për vitin 2021, së bashku me vendet e tjera në zhvillim si dhe ato të pazhvilluara në Azi dhe Afrikë. Duke pasur parasysh periudhën e gjatë kohore të kaluar, faqet zyrtare të MCC-së nënvizojnë se "pas zgjedhjeve parlamentare të Kosovës në shkurt 2021, MCC po angazhohet me qeverinë e re për të konfirmuar përkushtimin e vazhdueshëm të Kosovës"<sup>7</sup>. Megjithatë, diskutimet me qeverinë e re të Albin Kurtit nuk kaluan pa probleme, siç edhe jemi të informuar.

---

<sup>1</sup> Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit, "Raporti Vjetor 2017: Zhblokimi i Mundësisë - Vendet Partnere të MCC që përfunduan Kompaktet në Vitin Fiskal 2017", Mars 2018, i qasshëm në: <https://www.mcc.gov/resources/story/story-ar-2017-unlocking-opportunity>.

<sup>2</sup> Po aty

<sup>3</sup> Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit, "Raporti Vjetor 2019: Progresi Drejtues - Vendet Partnere të MCC që përfunduan Kompaktet në Vitin Fiskal 2019", Mars 2021, i qasshëm në: <https://www.mcc.gov/resources/story/story-ar-2019-driving-progress>

<sup>4</sup> <https://neësbeezer.com/greeceeng/kosovo-kurti-deletes-us-gas-pipeline-from-greece/>

<sup>5</sup> Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit, Ndhima Kompakt: Justifikimi i Buxhetit të Kongresit (CBJ): Justifikimi i Buxhetit të Kongresit, VF 2022, maj 2021, në internet nëpërmjet: <https://www.mcc.gov/resources/story/story-cbj-fy2022-compact-assistance>.

<sup>6</sup> Po aty

<sup>7</sup> Po aty.

Propozimi i projektit të Shteteve të Bashkuara synon të financojë shpërndarjen e gazit natyror që lidh vendet e Ballkanit Perëndimor duke ndërtuar një tubacion të ri gazi që fillon në Greqi. Gazi natyror amerikan do të importohet nga porti grek i Aleksandropulos, i lidhur me burimet e rrjetit TAP (Trans-Adriatic Pipeline) dhe do të arrijë në Kosovë përmes Maqedonisë së Veriut. Ekspertët e energjisë dhe politikanët e panë propozimin e gazsjellësit si një mënyrë për të devijuar Kosovën, dhe në të vërtetë rajonin e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, nga monopoli rus i tregut të energjisë në rajon. Më tej argumentohet se, për Kosovën, do t'i ofronte vendit të porsalindur mundësinë që të përdorë gazin natyror si lëndë djegëse të përkohshme derisa të ketë akses në hidrogjen<sup>8</sup>. Për çështjet e ndërtimit, Maqedonia e Veriut do të përfshihet në ndërtimin e lidhjes së saj me terminalin e gazit të gazsjellësit në Aleksandropulos (rreth 55 milionë euro, nga të cilat 13 milionë euro janë të siguruara nga fondet e BE-së). Në korrik 2021, vendet fqinje - Maqedonia e Veriut dhe Greqia nënshkruan një marrëveshje për ndërtimin e këtij gazsjellësi që do të lidh të dy vendet<sup>9</sup>.

Grantet prej 200 milionë dollarësh nga Shtetet e Bashkuara do të shpërndahen përmes MCC-së dhe degës së saj lokale, degës së saj Millennium Foundation Kosovo (MFK). Projekti do të diversifikonte dhe zgjeronte hartën energjetike në rajon në mënyrë që furnizimi të bëhet më i rregullt dhe natyrisht më i qëndrueshëm.

### III. DISKUTIMET E QEVERISË KURTI DHE REZULTATI JO I KËNAQSHËM

Në vitin 2021, Albin Kurti erdhi edhe një herë në pushtet si Kryeministër i Republikës së Kosovës. Që nga kthimi i tij në rolin qeverisës, pika kryesore e diskutimit mes kabinetit Kurti dhe administratës së ardhshme Biden ka qenë projekti i propozuar nga SHBA-të për gazsjellësin. Diskutimet mbi të ashtuquajturin Projektin e Ndërtimit të Infrastrukturës së Gazit në SHBA u zhvilluan ndërmjet qeverisë së udhëhequr nga Albin Kurti dhe MCC-së. Projekti i propozuar ndërkufitar po shkonte përpara paralelisht me bisedimet e tilla dypalëshe Kosovë-SHBA, siç theksohet në marrëveshjen e Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë në korrik 2021. Madje, qeveria greke shprehu gatishmërinë për të mbështetur Kosovën për t'iu bashkuar projektit<sup>10</sup> dhe në një takim dypalësh të korrikut 2021 mes Kurtit dhe ambasadorit amerikan në Athinë, ndër temat e diskutuara ishin edhe "investimi dhe energjia"<sup>11</sup>. Sa i përket financimit, kostoja e përgjithshme e projektit për Kosovën ishte rreth 600 milionë euro<sup>12</sup>. MCC, një agjenci federale e Shteteve të Bashkuara, premtoi 200 milionë dollarë për Kosovën, dhe fondet e mbetura thuhet se janë garantuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIFO).<sup>13</sup>

Diskutimet e qeverisë ishin mjaft të gjera në lidhje me këtë projekt-propozim për ndërtimin e një gazsjellësi që lidh Kosovën me TAP (Trans-Adriatic Pipeline). Pika kryesore e mosmarrëveshjes ishte qëndrueshmëria dhe sa ekologjikë do të ishte një investim i tillë shikuar

<sup>8</sup>Euroneës, "Projektin e gazsjellësit amerikan synon të krijojë një treg energjetik në rajon", 1 tetor 2021, në internet nëpërmjet:<https://euroneës.al/en/balkans/2021/10/01/us-pipeline-project-aims-to-create-an-energetic-market-amongst-countries-of-the-balkans/>.

<sup>9</sup>Po aty.

<sup>10</sup>Politiko, "Qeveria e Kosovës refuzon projektin amerikan për gazin natyror, Albin Kurti vendos kushte", 17 shtator 2021, online përmes: <https://politiko.al/english/kosova/qeveria-e-kosoves-refuzon-projektin-amerikan-per-gazin-natyror-albin-kurt-i443693>.

<sup>11</sup>Republika e Kosovës – Zyra e Kryeministrit, "Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka takuar ambasadorin e SHBA-së në Greqi, Geoffrey Pyatt". 9 July 2021, i qasshëm <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-prime-minister-of-the-republic-of-kosovo-albin-kurti-met-eith-the-us-ambassador-to-greece-geoffrey-pyatt/>.

<sup>12</sup>Euroneës, "Projektin e gazsjellësit amerikan synon të krijojë një treg energjetik në rajon", 1 tetor 2021.

<sup>13</sup>VOA, "Kosova tërhiqet ngaprojekti për gazsjellësin", 30 Shtator 2021, i qasshëm në: <https://www.zeramerikes.com/a/6252093.html>.

në afat të gjatë kohor. Dr. Artane Rizvanolli, ministre e Ekonomisë së Republikës së Kosovës, shtroi pyetjen në vijim: “A është më mirë të përdoret gaz si burim që lëshon dioksid karboni, por më pak se djegia e qymyrit, apo është më mirë të synohet një kalim i drejtpërdrejtë në burimet e ripërtëritshme të energjisë? Nuk është e qartë për momentin dhe kjo është diçka që do ta studiojmë në muajt në vijim”<sup>14</sup>. Në të vërtetë, energjia e ripërtëritshme është synimi kryesor i qeverisë, pa marrë parasysh nevojën për të mirëmbajtur domosdoshmërisht burime të tjera të furnizimit me energji. Thuhet se kryeministri Kurti i ka vendosur kushte të rrepta MCC-së për realizimin e projektit dhe ka kërkuar “s qarime shtesë, sa do të jetë kostoja totale, kush do t'i financojë, kush do ta ndërtojë infrastrukturën e gazit, dhe u tha se do të ndërtohej në partneritet publiko-privat. Do të na duhej të merrnim edhe kredi të mëdha për të përfunduar projektin, të cilat do të shlyheshin nga klientët. Vendimet nuk do të merren pa e ditur se sa do të kushtojë dhe pa e ditur se cili do të jetë çmimi që konsumatori do të paguajë për energjinë”<sup>15</sup>. Pak kohë më parë, më 29 shtator 2021, ca ditë para shpalljes së vendimit për refuzim, kryeministri Kurti u takua me përfaqësues të MCC-së dhe i falënderoi për “mbështetjen që MCC-ja i ka dhënë sektorit të energjisë në Kosovë (...) në veçanti për punën intensive dhe bashkëpunimin me Qeverinë në muajt e fundit”.<sup>16</sup> Ai po ashtu u zotua se do të vazhdojë të punojë së bashku edhe në vitet e ardhshme për të përfunduar sektorin e energjisë dhe ekonomisë së Kosovës.

Kushtet e paplotësuara si dhe përgjigjet e pa konkretizuara shpjen qeverinë e Kurtit drejt marrjes së vendimit refuzues për propozimin e gazsjellësit të mbështetur nga SHBA. Kryeministri ishte i qartë në arsyetimin se projekti duhet të mbyllet në mënyrë që të ndërmerren më shumë studime dhe të mblidhen më shumë informata përpara realizimit, gjë që kërkon kohë dhe investim financiar të qeverisë dhe taksapaguesve për një projekt të tillë madhor ndërkufitarë. Dy elementet kryesore që dërguan drejt këtij vendimi u parashtrua mungesa e informacioneve bindëse dhe përfundimtare mbi koston globale si dhe që ajo nuk është alternativa më e mirë për tranzicionin energjetik të Kosovës. Pas njoftimit të qytetarëve dhe mediave për vendimin refuzues të Qeverisë, Rizvanolli shtoi se afati i vendosur nga MCC nuk ishte fleksibil për të mundësuar më shumë diskutime për implikimet më të gjera të projektit për vendin.

Sa i përketë grantit tashmë të ndarë nga qeveria federale amerikane për Republikën e Kosovës, ministrja e Ekonomisë siguroi se nuk do të humbas. Në vend të kësaj, “fondet do të drejtohen në projekte të tjera energjetike të fokusuara në ruajtjen e energjisë, rrjetin elektrik dhe zgjidhjet e rrjeteve të mencura, dhe aftësitë për fuqinë punëtore, veçanërisht gratë”.<sup>17</sup> Ky vendim e bën Kosovën vendin e vetëm në rajonin e Ballkanit që e ka refuzuar furnizimin me gaz natyror nga një burim jorus. Në rajon, Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina janë konsumatorët kryesorë të Rusisë (përkatësisht Gazprom si prodhuesi kryesor i gazit natyror të lëngshëm).

#### IV. NDIKIMI NË SEKTORIN E ENERGJISË DHE IMAZHIN E KOSOVËS

Tani për tani mund të themi se plani dhe siguria energjetike e Republikës së Kosovës ka nevojë për diversifikim të burimeve për prodhimin e energjisë dhe një modernizim të përgjithshëm, duke përfshirë edhe gazifikimin. Energjia dhe energjia elektrike e Kosovës

---

<sup>14</sup> Balkan Green Energy Neës, “Kosova mbyll projektin e gazsjellësit të mbështetur nga SHBA”, 5 tetor 2021, i qasshëm në: <https://balkangreenenergyneës.com/kosovo-shelves-us-backed-gas-pipeline-project/>.

<sup>15</sup>Politiko, “Qeveria e Kosovës refuzon projektin amerikan për gazin natyror, vendos Albin Kurti vendos kushte”, 17 Shtator 2021

<sup>16</sup> Republika e Kosovës – Zyra e Kryeministrit, “Kryeministri Kurti priti në takim përfaqësuesit e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC)”, 29 shtator 2021, i qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister-kurti-received-in-a-meeting-the-representatives-of-the-millennium-challenge-corporation-mcc/>.

<sup>17</sup> <https://balkangreenenergyneës.com/kosovo-shelves-us-backed-gas-pipeline-project/>

aktualisht varen masivisht (më shumë se 90%) nga dy termocentralet e vjetra të linjitet (Kosova A dhe Kosova B) që funksionojnë qysh nga koha e Jugosllavisë, të cilat mbi të gjitha kontribuojnë masivisht në ndotjen e ajrit në vend. Kosova nuk ka infrastrukturë për nxjerrjen e naftës apo gazit dhe as importimin e gazit. Për shkak të kësaj, sektori energjetik i Kosovës është mjaft i vjetëruar dhe jo fleksibil.

Plani në vazhdim është të bëhet rindërtimi i termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, në mënyrë që të rritet prodhimi i brendshëm i energjisë si dhe të përmbushen detyrimet që Kosova ka si Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë që nga viti 2006.<sup>18</sup> Termocentralet e epokës jugosllave kanë pasur disa dështime të shërbimit dhe ndërprerje të energjisë, dhe për këtë arsye nuk janë në gjendje të importojnë energji elektrike, e lëre më t'i mbulojnë nevojat e qytetarëve. Një shënim i prillit 2021 nga Administrata Ndërkombëtare e Tregtisë (ITA) paralajmëroi se "Kosova aktualisht nuk është në gjendje të prodhojë energji elektrike të mjaftueshme brenda vendit për të përmbushur plotësisht kërkesën për energji. (...) Ekziston një nevojë jetike për prodhim të qëndrueshëm të energjisë me ngarkesë bazë në Kosovë që mund ta plotësojë kërkesën"<sup>19</sup>. Për të rritur nevojën për burime më të mira dhe më të larmishme të energjisë, kërkesa për energji elektrike ka kohë që ka tejkaluar ofertën, me konsumin dhe kërkesën për energji elektrike që është rritur mbi 90% midis vitit 2000 dhe 2010. Ky problem dhe kërkesa maksimale nuk pritet të ulet, por të vazhdojë të përshkallëzohet. Përfundimisht, për të përmirësuar këtë varësi nga qymyri dhe burimet e vjetruara të energjisë është lidhja e saj nëpërmjet projekteve ndërkufitare me vendet fqinje me tubacionet ekzistuese të naftës ose gazit. Në të vërtetë, ITA nënvizoi energjinë si sektorin e industrisë me perspektivë më të madhe për vendin e 'porsalindur'. Për të cituar më tej Bankën Botërore, "duke pasur parasysh këtë sfond, Qeveria e Kosovës ka prioritet modernizimin dhe përmirësimin e sektorit energjetik të vendit dhe ka kërkuar nga partnerët e saj zhvillimor, përfshirë Bankën Botërore, Komisionin Evropian, KfW, USAID-in, si dhe si donatorë të tjerë, për mbështetje dhe ndihmë"<sup>20</sup>. Përdorimi i energjisë në Kosovë udhëhiqet kryesisht nga amvisëritë, veçanërisht për qëllime ngrohjeje, por pa dyshim është joefikas dhe i paizoluuar. Përmirësimet apo zgjerimet e efikasitetit të energjisë janë në interes të konsumatorëve dhe statistikave qeveri-SHBA vlerësojnë se vendi humbet mbi 300 milionë USD në vit për shkak të furnizimit të tij jo të besueshëm me energji<sup>21</sup>.

Qeveria e Kosovës është e vendosur ta zbatojë prioritetin e saj kyç të investimit në burimet e ripërtëritshme të energjisë me garancë se sektori energjetik po hyn në një tranzicion të qëndrueshmërisë. Masat përfshijnë rritjen e efikasitetit energjetik, përkatësisht mbylljen e termocentraleve ekzistuese ose rindërtimin e tyre, duke u munduar gjithmonë të sigurojnë energji elektrike të përballueshme për qytetarët.

Duke parë më konkretisht tregun e gazit në Kosovë, me qëllim të përmbushjes së obligimeve brenda Komunitetit të Energjisë, qeveria miratoi Ligjin nr. 05/L-82 për Gazin Natyror më 13 korrik 2016, si pjesë e Paketës së Tretë më të gjerë të Legjislacionit për Energjinë Primare. Ligji përcakton parimet për organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, si dhe procedurat e lëshimit të autorizimit për shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe ruajtjen e

---

<sup>18</sup> Energy Community, "Kosovo", i qasshëm në: <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo.html> [i qasur më 4 Nëntor 2021].

<sup>19</sup> Administrata Ndërkombëtare e Tregtisë, "Udhëzues Komercial për Vending e Kosovës – Energji", përditësuar për herë të fundit më 4 tetor 2021, i qasshëm në: <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/kosovo-energy> [Accessed 4 November 2021].

<sup>20</sup> Banka Botërore, "Energjia në Kosovë", përditësuar për herë të fundit në tetor 2018, i qasshëm në: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/energy-in-kosovo> [Qasur më 4 nëntor 2021].

<sup>21</sup> Administrata Ndërkombëtare e Tregtisë, "Udhëzues Komercial për Vending e Kosovës – Energji", përditësuar për herë të fundit më 4 tetor 2021 [Qasur më 4 nëntor 2021].



gazit natyror dhe sistemeve operative<sup>22</sup>. Kur bëhet fjalë për gazin natyror, avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të këtij burimi energjie janë relativisht të barabarta, për këtë arsye vendimet refuzuese apo pajtuese për projektet e tubacioneve të gazit janë relativisht të tensionuara dhe të vështira për të dhënë një gjykim përfundimtar qoftë pozitiv apo negativ. Një vështrim i detajuar lidhur me përparësitë dhe joperparësitë e gazit natyror është dhënë më poshtë, në të njëjtin kapitull.

Mungesa e infrastrukturës moderne e tregut të gazit natyror në vend e vë Ksoven prapa në rajon kur bëhet fjalë për burimet e energjisë dhe lidhjen e tyre. Në të vërtetë, tubacionet e gazit dhe projekte të tjera të ngjashme zakonisht paraqiten për të ndërlidhur më mirë vendet e Ballkanit Perëndimor mes tyre dhe me vendet fqinje të BE-së.

Për shembull, në fillim të këtij viti, në janar, Serbia propozoi përgatitjen e dokumentacionit për ndërtimin e tubacioneve të gazit drejt Kosovës dhe Malit të Zi<sup>23</sup>. Ministri i Energjisë theksoi se "kjo i mundëson Serbisë të marrë gaz nga furnizues të ndryshëm"<sup>24</sup> për të përmbushur qëllimin e tyre për të diversifikuar burimet e tyre të furnizimit me gaz natyror. Ministri shtoi se "do të mundohemi të bëhemi korridor transit, nuk do të bllokojmë asnjë rrugë që duhet të kalojë përmes Serbisë"<sup>25</sup>. Janë dhënë shumë premtime për ndërtimin e infrastrukturave energjetike, duke përfshirë lidhjen e Serbisë me Bullgarinë deri në fillim të vitit 2023 nëpërmjet një lidhjeje gazi me të që të lidhet me EastMed, tubacioni i planifikuar që lidh burimet energjetike të Mesdheut Lindor me Greqinë nëpërmjet Qipros. Kjo politikë është shumë ndryshe nga ajo e qeverisë kosovare të udhëhequr nga Albin Kurti, e cila hodhi poshtë propozimin e financuar nga SHBA për një projekt të gazsjellësit që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, dhe më pas me Gazsjellësin Trans-Adriatik. Aspiratat e Serbisë lidhur me energjinë duket se janë në rrugë të ndryshme nga ato të Kosovës, e cila është e përkushtuar të zvogëlojë investimet e burimeve të ripërtrishme.

Për t'i kuptuar më mirë tubacionet e gazit si një projekt dhe investim, më poshtë është dhënë një përmbledhje e shkurtër mbi projektet e tjera kyçe të tubacioneve të gazit midis tregjeve evropiane dhe amerikane, dhe ndikimet e tyre në politikën e jashtme.

Tubacioni Yamal-Europe është një tubacion gazi natyror prej 4,107 km që mbulon Rusinë, Bjellorusinë, Poloninë dhe Gjermaninë që nga vitet 1990. Për sa i përket gjatësisë, në Rusi tubacioni shkon 402 km i gjatë, duke filluar nga qendra e gazit Torzhok dhe është në pronësi të Gazprom, vetë një ofruer kryesor i gazit natyror në Ballkanin Perëndimor. Në seksionet bjelloruse dhe polake të gazsjellësit ai shtrihet respektivisht 575 dhe 683 km gjatësi. Të njëjtat katër vende janë të lidhura gjithashtu nëpërmjet tubacionit të naftës Druzhba, i cili daton që nga vitet 1960 dhe lidh Rusinë lindore me Ukrainën, Bjellorusinë, Poloninë, Hungarinë, Sllovakinë, Republikën Çeke dhe Gjermaninë. Ai ka kapacitet të transportojë nga 1.2 milion deri në 1.4 milion fuçi naftë në ditë.

Tubacioni i gazit natyror Nord Stream 2 është një projekt që aktualisht është duke u realizuar në Detin Baltik, por ka vonesa për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe mjedisore. Pasi të përfundojë miratimi rregullator i energjisë, tubacioni 1,200 km do të jetë në gjendje të sigurojë 55 miliardë metra kub gaz natyror në Evropë në bazë vjetore. Projekti është në pronësi të Gazprom, një kompani me shumicë shtetërore ruse të gazit, që mundëson që gazi natyror rus të

---

<sup>22</sup> Komuniteti i Energjisë, "Gas\_13/Albania-Kosovo Gas (ALKOGAP) – Përshkrim i shkurtër i projektit", <https://author.energy-community.org/enc-author-prd/enc/regionalinitiatives/infrastructure/PLIMA/Gas13.html> [Accessed 4 Nentor 2021].

<sup>23</sup> Shih Lajmet, "Serbia do të fillojë përgatitjen e projekteve për tubacionet e gazit në Kosovë, Mali i Zi në vitin 2021 - min e energjisë", 29 janar 2021, i qasshëm në: <https://seeneës.com/neës/serbia-to-start-preparing-projects-for-gas-pipelines-to-kosovo-montenegro-in-2021-energy-min-729497>.

<sup>24</sup>Po aty

<sup>25</sup>Po aty

arrijë drejtpërdrejt në Gjermani (Vyborg në Lubmin). Edhe pse vlerësohet si një marrëveshje e shëndoshë biznesi, projekti legjitimon monopolin rus të furnizimit me gaz ose energji në disa rajone Qendrore dhe Lindore dhe angazhohet drejtpërdrejt me shtetin rus. Në fillim të vitit 2021, Parlamenti Evropian bëri thirrje që projekti i gazsjellësit Nord Stream 2 të ndërpritet pas arrestimit të Alexei Navalny në duart e qeverisë ruse, gjithashtu në një përpjekje për të penguar varësinë e mëtejshme nga burimet ruse të energjisë për gazin natyror. Ky qëndrim u mbështet nga administrata Biden, por jo nga kancelarja gjermane Angela Merkel. Gjithashtu ishte kritikuar për mos përmbajtje të objektivave klimatike të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane.

Në mënyrë të ngjashme, në Amerikën e Veriut gazsjellësi i naftës Keystone XL midis SHBA dhe Kanadasë ngjalli gjithashtu debate dhe kritika. Ambientalistët kanë paralajmëruar se rërat e veçanta të naftës sjellin një proces nxjerrjeje nafte që kërkon më shumë karburant, ujë dhe karbon. Megjithatë, nga ana e mbrojtësve, ata kujtojnë se ndërtimi do të krijonte rreth 42,100 vende pune në ndërtim (megjithëse për periudhën e përkohshme 2-vjeçare) dhe do të kontribuonte me rreth 3.4 miliardë dollarë në GDP-në e SHBA-së.

Duke u kthyer në Ballkanin Perëndimor, furnizimet me energji me gaz rrjedhin kryesisht nga Rusia. Deri më tani, vetëm Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria kanë ndërmarrë tashmë kontrata të shpërndarjes së gazit me LNG amerikan. Vlen të përmendet se gazi rus ka kostot më të ulët të shpërndarjes së gazit si dhe afërsia gjeografike, megjithatë vendet evropiane në përgjithësi janë duke u përpjekjur për të përdorur më shumë gazin natyror amerikan për të zvogëluar varësinë aktuale nga furnizimi rus.

Maqedonia e Veriut është e angazhuar në një infrastrukturë ndërkufitare të gazit për të importuar gaz natyror nga Greqia dhe, paralelisht, është bërë aksioner në një deponi gazi me gazin amerikan në Greqi. Shqipëria ka diversifikuar gjithashtu burimet e saj të energjisë, pasi ka nënshkruar kontrata me Exxon Mobile dhe Excelerate Energy për ndërtimin e një Terminali LNG në portin e Vlorës dhe me Snam italian për një depo nëntokësore gazi dhe tubacion për të furnizuar një termocentral aty pranë. Në anën tjetër, Mali i Zi së fundmi nisi një Dialog Ekonomik me SHBA-në, mes të cilit tema është diversifikimi i burimeve të energjisë. Së fundi, Kroacia, tashmë një Shtet Anëtar i BE-së, por një vend ballkanik dhe ish-jugosllav, nisi një terminal LNG me gaz natyror të SHBA-së, disa prej të cilit do të jenë në gjendje të arrijnë në entitetin boshnjako-kroat, pjesë e Bosnje-Hercegovinës. Megjithatë, pala serbe mbetet e përkushtuar ndaj gazit rus si burim energjie, duke pasur së fundmi madje edhe rritje të konsumit pas operacionalizimit të Rrjedhës Turke në janar 2021, një gazsjellës i madh që lidh një qendër ruse me një terminal turk dhe rrjetin e shpërndarjes duke kaluar Detin e Zi<sup>26</sup>.

## V. PËRPARËSITË DHE JOPËRPARËSITË E PROJEKTEVE TË GAZIT NATYROR

Seksioni i mëparshëm sqaroi se si sektori energjetik kosovar mund të lëkundet dhe të mbetet joefektiv me kundërshtimin e projekteve të gazit natyror, projekte në të cilat vendet fqinje kanë investuar për të zgjeruar shpërndarjen e energjisë, për të rritur besueshmërinë dhe madje për të ulur varësinë në gazin rus duke kontraktuar me LNG-në amerikane. Si mjet për të vlerësuar më së miri avantazhet dhe disavantazhet që mund të ketë projekti i propozuar i gazsjellësit të SHBA-së, ky seksion paraqet të dobijtë dhe dëmet e projekteve të gazit natyror.

